**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SKRAPAR**

***Skrapar me 20 / 04/ 2016***

## MBLEDHJA E FORUMIT TE BASHKERENDIMIT NE NIVEL VENDOR NE BASHKINE SKRAPAR

Mbledhja e Forumit te Bashkerendimit ne Nivel Vendor u mbajt ne ambientet e Bashkise Skrapar ne oren 13:00.Te pranishem ne kete takim ishin:

**Perfaqesues nga AKPT :** Z.Glejdi Floku
Z.Enxhi Masha

**Perfaqesues I Keshillit te Qarkut Berat :** Z. Dritan Rista

**Perfaqesues te Bashkise Berat :** Z. Fuat Shameti

**Perfaqesues te Bashkise Polican :** Z. Oligert Dyrmishi

**Perfaqsues te Bashkise Korce :** Znj. Zhaneta Lubonja
Znj. Elda Tona

**Perfaqsues te Bashkise Maliq :** Znj. Enkelejda Vincani

**Perfaqesuesit e Kompanise GAIA :** Z.Elton Toska
Znj.Boriana Vrusho
Z.George Bellas

**Perfaqesues te Bashkise Skrapar :** Z. Bledar Methoxha
Znj.Sonila Hysenbelli
Znj.Arisa Hidersha.

Fjalen e hapjes se takimit e mbajti **Z.Glejdi Floku Koordinator per PPV/AKPT**. Me fjalen e tij Z.Floku falenderoi pjesmarresit ne kete takim te dyte me forumin per hartimin e Planit te Pergjithshem Vendor dhe theksoi qe forumi eshte nje forum keshillimi.Me pas ai beri prezantimin e antareve te ketij forumi per Bashkine Skrapar .

Fjalen e mori Z. Elton Toska I cili beri Prezantimin e permbledhur te fazes se dyte te Hartimit te Planit te Pergjithshem Vendor per Bashkine Skrapar duke e ndare ne disa pika qe jane :

- ➢ Rezultate te Konsultimit te Fazes se Pare ( arritje e perfundimeve nga pyetesoret )
- ➢ Raport per perfundime te pergjithsheme te analizes se c'do sistem territorial.
- ➢ Percaktimi I nevojave te Bashkise nepermjet Analizes SWOT per c'do sistem individual territorial.
- ➢ Zhvillimi I vizionit te Bashkise ( strategji baze dhe formulimi I boshteve te prioritetit ).
- ➢ Formulimi I Action Plan.
- ➢ Formulimi I Pilot Project.
- ➢ ToRS per Detalied Local Plans
- ➢ Metodologjia dhe programi I Konsultimeve Publike.

Ne fjalen e tij Z.Toska theksoi 3 pika kryesore per Bashkine Skrapar qe jane :

1- Baza e forte ekonomike
2- Mjedisi Natyror
3- Turizmi

Me pas vazhdoi me analizen e 5 sistemeve territoriale si me poshte :

- ➢ Sistemi Natyror
- ➢ Sistemi Ujor
- ➢ Sistemi Bujqesor
- ➢ Sistemi Urban
- ➢ Sistemi Infrastrukturor

Kjo analize vinte ne dukje per secilin sistem pikat e forta,pikat e dobeta, mundesite dhe rreziqet.

Si pike me e forte duhet pare turizmi dhe monumentet natyrore/kulturore.

Nje pike e forte diskutimi dhe nga Bashkite Kufitare ishte mos shfrytezimi I guroreve qe eshte nje problem shume I madh sepse nuk eshte e lehte rehabiltimi I ketyre territoreve.

Vlen per te theksuar bashkepunimi me Bashkite fqinje si nje rrjet komunikimi ne te gjithe aspektet.

Nje mundesi shume e rendesishme per zhvillimin ekonomik te Bashkise se Skraparit eshte kultivimi I frutikultures sepse eshte shume I pershtatshem per zonen.Por kjo gje kerkon dhe trajnime te vazhdueshme per arritje te nje produkti cilesor dhe me standarte duke I certifikuar produktet.

Nuk mjaftojne vetem baxhot neper fshatra apo panairi I ushqimit qe ndodh vetem nje here ne vit per te dhene informimin rreth produkteve bujqesore apo blegtorale te zones.

Disa nga problematikat kryesore qe u diskutuan jane :

- Infrastuktura, lidhja midis fshatrave me njeri tjetrin si dhe me qytetin e Corovodes eshte shume e veshtire .
- Ngritja e Landfilleve eshte problem maksimal
- Mundesite per rikthimin e banoreve eshte shume e vogel nese nuk ka infrastukture.
- Mungesa e rrjeteve te internetit
- Shrytezimi shume I madh I burimeve ujore per ndertimin e hidrocentraleve.Duhet te kete nje lloj balance midis asaj qe kerkojme dhe asaj qe duhet.

Qellimi kryesor I Hartimit te ketij Plani per Bashkine e Skraparit eshte permirsimi I standarteve dhe cilesise se jetes nepermjet realizimit te objektivave strategjik per :

- Rrigjenerimin ekonomik
- Mjedisi
- Zhvillimi I Infrastruktures
- Krijimi I grupeve te qendrueshme.

Bashkia Skrapar ka rreth 35 projekte afatgjate por me prioritatret jane 9 projekte:

1- Lidhja Corovode - Korce- Gramsh.Duke hequr Skraparin nga nje zone Izolimi.
2- Lidhja e Corovodes me Njesite Administrative si Cepan,Vendreshe e Madhe,Potom,Leshnje te cilat kane perqindje te larte te popullsise.
3- Zhvillim I qendrushem ne zonen hyrese te qytetit.
4- Rreth kesaj zone Imianti I Trajtimit te Ujrave te Zeza.

5- Projekt Strategji promovim turizem.
6- Mbeshtetja per produktet bujqesore e blegtorale ( krijimi I disa pikave grumbullimi apo zona frigoriferike.
7- Certifikimi I produkteve bujqesore dhe blegtorale.
8- Krijimi I aktiviteteve sherbim – argetim ne Parkun Kombetar te Tomorrit.
9- Krijimi I rruges se mjedisit natyror dhe kulturor pergjate lumit te Tomorrices.

Ne mbyllje te fjales se tij Z.Toska permendi Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis per Hartimin e ketij Plani qe do te analizohet me shume ne Fazen e 3 te tij.

Si sugjerim nga perfaqesuesit e AKPT – se per Hartuesit e ketij Plani Studios GAIA ,duhet te merret shume parasysh edhe Ngrohja Globale.

Perfaqesuesit e Bashkise Korce dhane kerkesen per bashkepunim per ndertimin e rruges dhe lidhjen perfundimisht me keto 2 qytete fqinje.

Bashkite fqinje duhet te dine c'do lloj informacioni per interest e perbashketa dhe duhet te kene nje bashkepunim shume te forte.

**Protokolloi**
**Arisa HIDERSHA**

**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT**
**DREJTORI**
**Bledar METHOXHA**